



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **ZYRA E PERSONELIT**

**Nr. 13-111/01-49890/19**

**Podujevë,**

**Më:24.06.2019**

Bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Kosovës nr. 03/L - 149 të nenit 11 pika 1, si dhe të të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Podujevës mori vendim të rishpall:

## **K O N K U R S**

**Për plotësimin e vendit të lirë të punës:**

### **Drejtoria e Inspeksionit**

**Titulli i vendit të punës:** Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit

**Numri i Referencës:**RN00005079

**Grada :** 8

**Koeficienti:** 7

**Lloji i pozitës :** I karrierës, duke përfshirë periudhën provuese 1 (një) vjeçare

**Kategoria funksionale:** Profesional 3

**Përgjegjësia mbikëqyrëse:** PO

**Orari i punës :** 40 orë në javë

**Mbikëqyrësi :** Udhëheqësi i Sektorit dhe Drejtori i Drejtorisë

### **Qëllimi i vendit të punës**

- Zbatimin e legjislacionit në funksion të mbrojtjes së ambientit.

### **Detyrat kryesore:**

- 1.Inspektimin e të gjitha pronave, ndërtesave, instalimeve dhe pajisjeve të cilat i përkasin ose menaxhohen nga secili person juridik ose fizik e që konsiderohen të jenë relevante për shoqërinë njerëzore.
- 2.Inspektimi i Ndotjes së Ajrit, Ujit, Tokës të shkaktuara nga veprimtaritë industriale, urbane dhe rurale
- 3.Inspektimi në kontaminim, mbeturinave, materieve të rrezikshme dhe zonave të mbrojtura të natyrës, inspektimin duke zbatuar të drejtën për të inspektuar pa njoftim ose pëlqimin paraprak të pronarit, i cili menaxhon objektin e caktuar .
- 4.Bënë mbikëqyrjen e ujit, ajrit, tokës si çështje të ngritura ekologjike, duke kërkuar nga ndotësit potencial që patjetër të zbatojnë kërkesat mjedisore në pajtim me Ligjin.
- 5.Bënë mbikëqyrjen e eksploatimit të resurseve natyrore dhe ujore (nxjerrja e rërës nepër lumenj) nga aspekti i mbrojtjes së ambientit
- 6.Bënë mbikëqyrjen e punëve të seperacioneve, gurthyesve minjerave dhe makinave shpuese.

7. Jep pëlqime për eksploitim të resurseve natyrore, lejet ujore, jep pëlqime mjedisore  
8. Bënë mbikëqyrjen e zonave të mbrojtura të natyres dhe zonave me vlerë natyrore, ushtron fletëparaqitje për shkelje të dispozitave me të cilat bëhet kundervajtje

**Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:**

- Diplomë universitare, Drejtimi Ekologji, drejtime të Mbrojtjes së Mjedisit, Biologji , 3 vite përvojë pune profesionale
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

**INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT**

**Dokumentet e domosdoshme që duhet ti bashkangjiten aplikacionit janë:**

- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Diplomen e fakultetit te kryer të nivelit përkatës (fotokopje e vërtetuar)
- Dëshmitë për përvojë pune
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (për arsye të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve kërkohet në fund të procedurës së rekrutimit vetëm nga kandidati më i suksesshëm)
- Dokumentet i dërgoni fotokopje sepse të njëjtat nuk kthehen.

**Data e shpalljes së Konkursit: 24.06.2019 deri më 08.07.2019**

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në tabelën e shpalljeve

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Zyrën e Personelit, në këtë numër të telefonit 038/ 570 – 732 / lok.126.



**U.D i Udhëheqësit të Personelit**

**Blerim Nishevci**